



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.78 Akti

Nr. 136 Vendimi

Tiranë, më 09.04.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa
Pamela Qirko
Xhensila Pine

Kryesuese
Anëtare
Relatore

në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në datën 2 prill 2019, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Fehmi Petku, Gjyqtar/Kryetar i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe atë profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi A. Petku, ushtron detyrën e gjyqtarit/kryetarit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi A. Petku, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, në datën 15.01.2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
3. Në referim të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.
4. Trupit gjykues, zhvilloi mbledhjen e tij të parë, datë 24.01.2018, ku anëtarët caktuan me mirëkuptim kryesuesin e trupit gjykues, znj. Genta Tafa. Në respektim të legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit, anëtarët e trupit gjykues deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, si fillimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim KLD).
6. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me shkresën me nr. *** prot., datë 10.01.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016.
7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport fillestar me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, por ky raport është hartuar në mungesë të informacionit nga njëri prej organeve ligjzbatuese. Pas ardhjes së informacionit të munguar, DSIK-ja ka rishikuar raportin për subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku e ka dërguar raportin perfundimtar me shkresën nr. *** prot., datë 15.02.2018.
8. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Fehmi Petku, dhe ka dërguar me shkresën me nr. *** prot., datë 04.04.2018, raportin e vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku.
9. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke u kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, më datë 19.02.2019, vendosi përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, pasi provat kishin nivelin provueshmërisë sipas ligjit nr. 84/2016.

11. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për t'u njohur me materialet e dosjes e për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, më datë 19.02.2019.

12. Subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku me shkresën nr. *** prot., datë 25.02.2019, protokolluar me tonën me nr. *** prot., datë 25.02.2019, i është drejtuar Komisionit me kërkesën për t'u pajisur me kopje të plotë të dokumenteve.

13. Komisioni, më datën 26.02.2019, me procesverbalin nr. *** prot., date 26.02.2019 i ka vënë dispozicion materialin e printuar të hetimit administrativ dhe në format CD.

14. Subjekti i rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 27.02.2019, protokolluar me tonën me nr. *** prot., datë 27.02.2019, i është drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me kërkesën për t'u pajisur me raportin fillestar të DSIK-së me nr. *** prot., datë 02.11.2017.

15. Me vendimin nr. 3, të datës 05.03.2019, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi rihapjen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe kërkoi deklasifikimin e raportit fillestar të DSIK-së me nr. *** prot., datë 02.11.2017.

16. Komisioni, më 11.03.2019, pas deklasifikimit, i vuri në dispozicion subjektit të rivlerësimit një kopje të raportit të DSIK-së me nr. *** prot., datë 02.11.2017,

17. Me vendimin nr. 4, datë 11.03.2019, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shtyrje të afatit, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për vlerësimin e figurës të rihapur në datën 05.03.2019 dhe të shtyjë afatin e dorëzimit të shpjegimeve dhe provave në lidhje me rezultatet e hetimit me 7 ditë kalendarike.

18. Me vendimin nr. 5, datë 27.03.2019, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për caktimin e një grupi ekspertësh vlerësues të pasurisë dhe ekspertëve financiarë, vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, bazuar në pikën 6/a/c, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, me arsyetimin se: Komisioni ka tagrin dhe kapacitetin e plotë që të bëjë vlerësimin mbi të ardhurat e tjera të subjektit dhe personave të lidhur, duke kryer një hetim të thellë administrativ sipas neneve 45, 49, 50 të ligjit nr. 84/2016 e se subjekti i rivlerësimit, i njohur me rezultatet paraprake të hetimit deri në ditën e seancës dëgjimore, ka mundësinë për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

19. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin nr. 6, datë 27.03.2019, ftoi subjektin e rivlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 02.04.2019, ora 12:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

21. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 02.04.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, Tiranë, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

22. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT NGA KOMISIONI

23. Procesi i rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, i cili mbështetet në Aneksin e Kushtetutës, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

24. Në referim të dispozitave ligjore kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, si dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 2 e 17, të vitit 2017, Komisioni, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A.VLERËSIMI I PASURISË

25. Subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe ka dorëzuar pranë këtij institucioni deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 – 2016 dhe në zbatim të nenit 31/1, të ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar në datën 30.01.2017, pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar.

26. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja është bërë pas marrjes së deklaratës së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, dorëzuar në ILDKPKI, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*” dhe në përfundim në raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar është konstatuar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Ka fshehje të pasurisë;*
- *Ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/1 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu një hetim të pavarur¹ dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, lidhur me

¹“41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni

verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve, me burimet e krijimit të pasurive të deklaruara në deklaratën “Vetting” të subjektit të rivlerësimit,

27. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku ka deklaruar të fituara si trashëgimtar ligjor i babait të tij, A. P, sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2015, notere M. J, pasuritë të paluajtshme si më poshtë:

1) Truall me sipërfaqe 372 m², fituar me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 09.09.1960. Shitës: Komiteti Ekzekutiv, Tiranë; blerës A. S. P. E regjistruar në ZVRPP-në Tiranë. Certifikatë pronësie nr. ***. Nr. i pasurisë: ***; zk. ***, vol. ***, f. ***. Vlera e blerjes në shtator 1960 – 7440 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

2) Banesë mbi truallin e mësipërm, e përbërë nga tri kate, bodrum dhe papafingo. Ndërtuar në vitet 1994 – 1995. Legalizuar me proces legalizimi pranë ALUIZNI-t Tiranë (procedurë e nisur që nga viti 2006, sipas dosjes përkatëse të ALUIZN-it). Regjistruar në regjistrat e ZRPP-së Tiranë. Sipërfaqe totale ndërtimi: 1150 m²; e pavlerësuar deri në këto momente. Pjesa takuese 1/4. Adresa: Lagja nr. ***, Rr. “****”, nr. ***, Tiranë. Certifikatë pronësie me nr. ***, nr. pasurisë ***, zk ***, vol. ***, f. ***. E ndërtuar nga babai i tij, trashëgimlënësi A. S. P, në vitet ’93 -’94 - ’95.

3) Truall me sipërfaqe 6000 mijë m², blerë me dy kontratat e shitblerjes si më poshtë:

a) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.08.1996, të noteres M. Sh, shitës K. B, blerës A. P, sip. 4000 m², çmimi 1500 lekë/m². Vlera e blerjes 6.000.000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

b) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.08.1996, notere M. Sh. Shitës N. B, blerës A. P, sip. 2000 m², çmimi 1500 lekë/m². Vlera e blerjes 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

Adresa për të dyja sipërfaqet e mësipërme është: Rr. “****”, fshati ***, Sauk, Tiranë. Pronat e mësipërme nuk janë të regjistruara në ZVRPP.

4) Një shtëpi banimi të ndërtuar mbi truallin e mësipërm, e përbërë nga dy kate banimi dhe bodrume me sip. kati 130 m². Banesa ka përfunduar procesin e legalizimit, proces i cili ka filluar në vitin 2005, mbi bazën e vetëdeklarimit të bërë nga babai i subjektit, trashëgimlënësi A. S. P. Kjo banesë ka kaluar në emrin e tij gjatë procedurave të legalizimit mbi bazën e dëshmisë së trashëgimisë ligjore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2015, të noteres M. J, si dhe të deklaratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.09.2016, të noteres M. J, me të cilën trashëgimtarët e tjerë ligjorë të trashëgimlënësit A. S. P kanë hequr dorë nga çdo pretendim pronësie mbi këtë banesë dhe legalizimin e saj vetëm në emrin e tij. Kjo banesë aktualisht

dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

ndodhet në proces regjistrimi në ZVRPP-në Tiranë. E pavlerësuar deri sot. Pjesa takuese: 100 %

5) Truall me sipërfaqe 16000 m², blerë si më poshtë:

a) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.07.1996, të noteres M. Sh; shitës F. Sh, blerës A. P, sip. 4500 m², çmimi 500 lekë/m². Vlera 4500m² x 500 lekë/m² = 2 250 000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

b) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.07.1996, të noteres M. Sh; shitës O. B, blerës A. P, sip. 250 m², çmimi 500 lekë/m². Vlera 200 m² x 500 lekë/m² = 125.000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

c) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.08.1996, të noteres M. Sh; shitës O. B, blerës A. P sip. 200 m² x 500 lekë/m² = 100.000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

ç) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.07.1996, të noteres M. Sh; shitës F. Sh, blerës A. P, sip. 632 m², çmimi 500 lekë/m². Vlera 632 m² x 500 lekë/m² = 316000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

6) Pasuri e paluajtshme tokë bujqësore, e ndodhur në fshatin ***, Komuna Shqiten, Bashkia Kukës, sipërfaqe afërsisht 100000 m², pasuri trashëgimore e vjetër. E konfiskuar nga Pushteti Popullor për motive politike, e rimarrë si pronë në gusht të vitit 1991 gjatë procesit të rishpërndarjes së tokave bujqësore në Komunën Shqiten, sipas ligjit 7501 “ Për tokën”, ligj i cili në zonën e Kukësit është zbatuar duke rimarrë çdo ish-pronar tokën e vet.

Kjo pronë është e paregjistruar në regjistrat e ZVRPP-së Kukës. Aktualisht: në proces gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për fitimin e pronësisë. E pavlerësuar si pasuri e paluajtshme deri më sot për mungesë të pronësisë ligjore. Pjesa takuese: 1/4.

28. Nga dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18 qershor 2015, rezulton se z. Fehmi Petku ka kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për babanë e tij, të ndjerin A. S. P, vdekur në Tiranë, në datën 29.11.2014;

- me vullnetin e saj të lirë, znj. V. N (P.), ka hequr dorë plotësisht dhe përfundimisht nga trashëgimia;

- trashëgimtarë të pasurisë së z. A. S. P janë Xh. P., S. P, I. P dhe Fehmi Petku, në pjesë të barabarta, 1/4 pjesë secili.

28. Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar² se për ndërtimin e banesës së ndodhur në adresën Rr. “****” ka shërbyer si burim buxheti familjar i mbledhur në 14 vitet e fundit para ndërtimit të kësaj banesë, ndërsa me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj banese me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.04.1996, me shoqërinë “****” janë krijuar dhe të gjitha pronat e tjera në vitin 1996 dhe se nga ai vit nuk është shtuar asnjë pasuri tjetër.

29. Shtetasi A. P, i përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.03.1996, nga djali i tij S. P, i shiti shtetasit V. A (administrator i shoqërisë huamarrëse “****”) shtëpinë e ndodhur në Tiranë, në Rr. “****”, nr. ***, me përbërje: bodrume dhe tri kate të ndërtuara, për vlerën 520.000 USD.

² Sqarime të subjektit të rivlerësimit, z. Fehmi Petku, dërguar Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2018, në dosjen e Komisionit.

30. Për arsye se shitja e kesaj banese në rrugën “****”, nr. ***, kishte ndodhur në kohën kur subjekti i rivlerësimit ishte në funksion dhe kjo shitje kishte shërbyer si burim krijimi i pronave të tjera, trupi gjykues hetoi në lidhje me këtë banese e nga hetimi rezultoi se:

30.1 Pyetëtori i dërguar në datën 08 tetor 2018, referonte pyetjen se cili ka qenë burimi i të ardhurave të babait të subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurive të paluajtshme, në vlerë 23.991.000 lekë në periudhën 1996 – 1997, sipas tabelës më poshtë:

Përshkrimi	Periudha	Vlera/lek
Blerje truall në Sauk 5300 m ²	1996	7950000
Blerje truall me sip. 4500 m ² , nga F. Sh, ***, ***	1996	2250000
Blerje truall me sip. 450 m ² (200 + 250), nga O. ***, ***, ***, ***	1996	225000
Blerje truall me sip. 632 m ² , nga F. Sh, ***, ***	1996	316000
Blerje trualli me sip. 10 000 m ² , në ***, ***, pa akt blerje	1996-1997	1250000
Blerje tokë bujqësore me sip. 6000 m ² , Vaqar, Tiranë	1997	12000000
Total		23.991.000

30.2 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi në përgjigje të këtij pyetëtori se: *“Burimi i të ardhurave për blerjen e pasurive të mësipërme kanë qenë vlerat monetare të përfituara nga shitja e banesës në pronësi të babait tim, A. P, me kontratën noteriale të shitblerjes me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 19.04.1996 kompanisë “****”, përkundrejt shumës 520.000 USD. Nga shuma e mësipërme, vlera prej 250.000 USD është depozituar me kontratë huaje pranë kompanisë. Ndërsa pjesa tjetër e përfitur nga çmimi i shitjes në masën prej 270.000 USD, së bashku me interesat e përfituara nga kontrata e huas, janë përdorur për blerjen e të gjitha pasurive të mësipërme. Siç rezulton fare e qartë nga të dhënat financiare si më sipër, babai im ka zotëruar një buxhet shumë më të madh se vlera e pasurive të blera me paratë e siguruar nga shitja e banesës në pronësi të tij e ndodhur në rrugën “****”, nr. 15, buxhet i cili, siç ju kam shpjeguar në pyetjen 3.5, ka shërbyer për ndërtimin e fazës së parë, për të tria banesat në Sauk.”*

30.3 Mes palëve A. P dhe shoqërisë “****” ka pasur një proces të gjatë gjyqësor, si vijon:

30.4 Gjykata Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur deklarinimin e pavlefshëm të kontratës së shitjes nr. ***, datë 19.04.1996, mes palëve A. P dhe shoqërisë “****” dhe kthimin e saj në gjendjen fillestare, me vendimin, nr. ***, datë 04.11.2002,

30.5 Sipas këtij vendimi, *“Midis palëve është lidhur kontrata e huas, datë 27.04.1996, me anë të së cilës i padituri kundërpaditës A. P i ka dhënë hua shoqërisë shumë prej 475.000 USD dhe 800.000 lekë me afat kthimi 6 muaj, me interes 8 %, e me pas më datë 28.04.1996, , u lidh një aktmarrëveshje sipas të cilës shitësi i sendit do të mbante në përdorim banesën e shitur, derisa shoqëria, të shlyente detyrimet e marra me kontratën e huas, datë 27.04.1996.*

30.6 Gjykata e Apelit Tiranë, vendosi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 04.11.2002, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e me vendim nr. ***, datë 13.05.2003, detyroi palën

paditëse shoqëria “****” në administrim të njohë pronar të vetëm z. A. P mbi banesën e ndodhur në Rr. “****”, dhe anulimin e aktit administrativ për lirimin dhe dorëzimin e banesës nga i padituri kundrapaditës.

30.7 Gjykata e Lartë me vendim nr. ***, datë 13.05.2003, vendosi prishjen e vendimit nr. ***, datë 13.06.2003, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim asaj gjykate me tjetër trup gjykues.

30.8 Gjatë zhvillimit të këtij procesi i padituri kundrapaditës A. P, paraqiti pretendimet e tij, më datë 13.01.2005, para Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas të cilave me kontratën e shitjes nr. ***, datë 19.04.1996, i ka shitur shoqërisë “****” shtëpinë private të ndodhur në Rr. “****” në vlerën 520.000 USD. Pas shitjes së shtëpisë ai ka depozituar pranë shoqërisë “****”, me kontratën e huasë dt.27.04.1996 shumën prej 475 000USD e 800 000 lekë, me afat të përcaktuar 6 mujor me interes 8%.

30.9 Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata Apelit Tiranë, ka vendosur shuarja e detyrimeve të ndërsjella dhe njohjen si pronar të vetëm të z. A. P, për banesën e ndodhur në Rr. “****”.

31. Komisioni i kërkoi informacion Administratorit të Shoqërive Huamarrëse në Administrim, mbi marrëdhëniet e huas që kanë ekzistuar mes shtetasit A. P dhe përfaqësuesit të tij, z. S. P, me shoqërinë “****”, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, për huan në shumën prej 250.000 USD, në datë 27.04.1996, për një afat 6-mujor me interes 8 % dhënë shoqërisë “****”, nga përfaqësuesi i shtetasit A. P, z. S.P , sipas kontratës së huas, nr. ***, datë 27.04.1996, si dhe hua për shumën prej 225.000 USD + 800.000 lekë dhënë shoqërisë “****”, në datën 25.10.1996, nga përfaqësuesi i shtetasit A. P, z. S. P, sipas kontratës së huas nr. 19493, datë 27.04.1996.

32. Shoqëritë huamarrëse në administrim, informuan Komisionin mbi marrëdhëniet e huas me shoqërinë “****” dhe veprimet financiare të kryera në emër të z. S.P, në bazë të kontratës së huas, datës 27.04.1996, sipas të cilave: shuma totale e depozituar është: 475.000 USD; shuma e kapitalit të tërhequr është: 80.000 USD; shuma totale e interesave të tërhequr: 234.091 USD. Në total shuma e tërhequr kapital + interesa është e barabartë me 314.091 USD.

33. Në këtë shkresë referohen një numër veprimesh financiare (arkëtime dhe pagesa), të cilat nuk pasqyrohen në dokumentacionin bashkëlidhur dhe, për këtë arsye, u vlerësua e nevojshme thirrja e një seance dëgjimore me përfaqësues të shoqërive huamarrëse në administrim.

34. Në datën 12.11.2018 u zhvillua seanca dëgjimore në ambientet e Komisionit dhe në të morën pjesë z. V. M dhe z. A. Q me detyrë specialistë-ekonomistë, të pajisur me autorizimin nr. *** prot., datë 12.11.2018, nga administratori G. L.

35. Nga procesverbali i mbajtur gjatë seancës dëgjimore³, referuar përgjigjeve të specialistëve, rezulton se nga shoqëritë huamarrëse në administrim nuk disponohen mandate, por iu janë referuar të dhënave nga kompjuteri, të cilat janë përpunuar nga Qendra e Informatizimit Financiar, mbi bazën e të cilit ka dalë koeficienti.

³ Procesverbalin e seancës dëgjimore me përfaqësuesit e SJHA-së, datë 12.11.2018, në dosjen e Komisionit.

36. Kjo konfirmohet edhe nga shkresa e shoqërive huamarrëse në administrim, në të cilën informohet⁴ se të gjithë kreditorët e shoqërisë “****” kanë qenë të regjistruar në kompjuterin e kësaj kompanie. Çdo kreditori i hapej një kartelë dhe kontrata e huas që lidhej me të lëshohej në një kopje dhe i jepej kreditorit.

37. Gjithashtu, të gjitha lëvizjet financiare, si tërheqje dhe depozitime (pagesa/arkëtime) regjistroheshin në kompjuterin e kompanisë dhe një kopje e mandatar-këtimit/pagesës i jepej kreditorit. Nga ana e shoqërive huamarrëse në administrim informohet se disponohet vetëm kartela e kreditorit, e cila është përpunuar nga Qendra e Informatizimit Financiar.

38. Në vijim të seancës dëgjimore dhe në referencë të dokumentacionit të dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 13.11.2018, të shoqërive huamarrëse në administrim, konkretisht kartelës së kontratës nr. ***, datë 27.04.1996, u kërkua⁵ të vendosen në dispozicion të Komisionit aktet si vijon:

- * kontrata nr. *** dhe kontrata nr. ***;
- * kopje të kartelave me historikun përkatës origjinale e të certifikuara nga audituesi;
- * si dhe informacion mbi dokumentimin dhe veprime financiare të kryera.

39. Shoqëritë huamarrëse në administrim⁶ vunë në dispozicion Komisionit sa vijon:

- u vu në dispozicion kontrata nr. ***, në emër të z. S. P e cila disponohet vetem fotokopje;
- kontrata nr. ***, nuk disponohet dhe nuk ka informacion se në emër të kujt është;
- fotokopja e kartelës nr. ***, e cila i përket kreditorit S. P, e llogaritur dhe e përpunuar nga Qendra e Informatizimit Financiar dhe firma “Datech”.

40. Në lidhje me derdhjen e kapitalit të datës 27.04.1996, në shumën 250.000 USD, referuar rregullit të firmës piramidale “****”, që kreditori shkante pranë sporteleve tek arka e kreditit, depozitonte shumën dhe më pas nënshkruante një kontratë huaje, mendohet që është derdhur në arkë.

41. Në lidhje me përshkrimin e veprimit të datës 27.07.1996 dhe me mënyrën e tërheqjes së interesit prej 60.000 USD, informohet se kjo vlerë është një interes i përlllogaritur për periudhën tremujore (27.04.1996 - 27.07.1996), pasi kreditori ka tërhequr për çdo muaj shumën prej 20.000 USD. Ky interes është tërhequr në arkën e kreditit dhe veprimi është pasqyruar në kartelën e kreditorit.

42. Në lidhje me përshkrimin e veprimeve të datave 23.10.1997 dhe 06.11.1997, informohet se bëhet fjalë për sistemim veprimi që ka të bëjë me shumën e tërheqjes së kapitalit prej 80.000 USD (79.385 USD + 615 USD = 80.000 USD) nga ana e z. S.P tek arka qendrore e firmës “****”, sipas mandatpagesës nr. 91, datë 14.02.1997, duke ia zbritur nga kartela si shumë kapitali e tërhequr.

⁴ Shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 08.11.2018, të shoqërive huamarrëse në administrim në dosjen e Komisionit.

⁵ Shkresë nr. *** prot, datë 13.11.2018, drejtuar administratorit të shoqërive huamarrëse, në dosjen e Komisionit.

⁶ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.11.2018, nga shoqëritë huamarrëse në administrim, në dosjen e Komisionit.

43. Në lidhje me faktin nëse shtetasi A. P është debitor në shoqërinë “****” sh.p.k., në administrim, informohet se ai nuk është debitor, kurse shtetasi S.P është shpallur debitor për shumën 80.000 USD dhe është dërguar për ekzekutim zyrës së përmbarrimit.

43.1 Në lidhje me periudhën e kalimit në administrim të dokumentacionit të shoqërisë “****”, informohet se shoqëria ka kryer veprimtari financiare, kryesisht pagesa të ndryshme deri në datën 31 janar 1998 dhe, pas miratimit të VKM-së nr. 65, datë 30.01.1998, është bërë pezullimi i veprimeve financiare të ish-firmave piramidale.

44. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, iu kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë:

- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë me dokumentacion provues ligjor për burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe dokumentacion ligjor provues për të provuar se të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie shtëpi banimi kanë qenë burim i krijimit të pasurive të tjera, të deklaruara në deklaratën “Vetting”.
- Duket se ka mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive të babait të subjektit të rivlerësimit në vitet 1994 – 1996 në vlerën –34.963.859 lekë.
- Duket se subjekti ka gjykuar një çështje duke qenë në kushtet kur duhet të hiqte dorë nga gjykimi i çështjes, pasi kanë ekzistuar shkaqet për njëanshmëri sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale (neni 17 i KPP-së), kur palë në gjykim ka qenë shtetasi V. A, me të cilin babai i subjektit ka pasur një marrëdhënie interesi.

45. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi rezultatet e hetimit duke pretenduar: *“Nga ana e Komisionit, në mënyrë jo të drejtë pretendohet se të gjitha pasuritë e paluajtshme, të vëna nga paratë e përfituara nga shitja e banesës së ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, nr. ***, janë krijuar deri më 31 dhjetor 1996. Nga ana tjetër, duke i konsideruar të gjitha pronat si të krijuara deri në datën 31 dhjetor 1996, mohohen padrejtësisht burimet financiare të familjes, të krijuara nga 1 janari i vitit 1997 deri në vitin 2002, të ardhura të cilat i kam paraqitur me dokumente përkatëse para Komisionit në përgjigje të pyetësorit shtesë dhe që po i citoj edhe në këtë material”.*

Analiza ligjore

46. Referuar informacionit të dërguar nga shoqëritë huamarrëse në Administrim, rezulton se ka deklarime të paqarta dhe kontradiktore me dokumentacionin shoqërues, si dhe me aktet juridike të përdorura gjatë procesit gjyqësor ndërmjet shtetasit A. P, me përfaqësues z. S. P dhe shoqërisë “****”, në faktin se:

- kontrata dhe kartela nr. *** janë në emër të z. S.P dhe data e krijimit është 27.04.1996. Në këto veprime nuk figuron fare emri i z. A. P.

46.1 Referuar kësaj kartele rezulton:

- një derdhje kapitali (pa numër mandatarkëtimi dhe numër urdhërshirimi bankar), në datë 27.04.1996, në vlerë 250.000 lekë. Në shpjegimin e tyre shoqëritë huamarrëse në administrim,

kanë deklaruar që “*mendohet që është derdhur në arkë*”, pra, nuk ka informacion të qartë për mënyrën dhe dokumentimin e derdhjes.

46.2 Referuar kontratës së huas, datë 27.04.1996, huadhënësi S. P, i jep kompanisë “****” (V. A) hua në shumën prej 250.000 USD + 225.000 USD + 800 000 lekë (475.000 USD + 800.000 lekë), me një afat prej 6 muajsh me 8 % në muaj. Huamarrësi V. A, deklaroi se mori në dorëzim shumën e dhënë dhe se do të respektojë afatin dhe kthimin e saj në shumën përfundimtare në USD.

46.3 Shuma e derdhur, në datë 27.04.1996, referuar kontratës është 475.000 USD dhe 800.000 lekë, ndërsa në kartelën nr. ***, në emër të z. S. P është pasqyruar derdhje vetëm e shumës 250.000 USD, në këtë datë.

- Në kartelën e sipërpërmendur, në datë 25.10.1996, është pasqyruar një veprim mandatarkëtim nr. ***, në vlerë 225.000 USD, me përshkrimin “vjen nga kartela ***”. Për këtë kartelë nga shoqëritë huamarrëse në administrim, është deklaruar që: “kontrata nr. *** nuk disponohet dhe nuk ka informacion në emër të kujt është”.

46.4 Ka mospërputhje të vlerës së deklaruar marrë në dorëzim, në datë 27.04.1996, me derdhje kapitali referuar karteles në të njëjtën datë me një diferencë 225.000 USD dhe 800.000 lekë,.

46.5 Ka mungesë informacioni të kontratës nr. *** dhe kartelës përkatëse nga e cila ka ardhur shuma prej 225.000 USD, në datën 25.10.1996, në kartelën nr. ***.

46.6 Referuar kësaj karteles, për periudhën 27.07.1996 – 31.12.1996, është tërhequr shuma prej 197.200 USD interesa nga shtetasi S. P.

46.7 Gjithashtu në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni, vëren se ka ndryshim të kohës dhe të burimit të ligjor të krijimit të pasurive të sipërcituara pasi në sqarimet e datës 15.10.2018 deklarohet që me të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në Rr. “****”, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.04.1996, me shoqërinë “****”, janë krijuar dhe të gjitha pronat e tjera në vitin 1996 dhe se nga ai vit nuk është shtuar asnjë pasuri tjetër.

46.8 Ndërsa në kundërshtim me sa me sipër pas kalimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit deklaroi që pasuritë janë krijuar deri në vitin 2002, duke përdorur *burimet financiare të familjes, të krijuara nga 1 janari i vitit 1997 deri në vitin 2002*.

46.9 Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës janë të ndryshme nga ato të dhëna nga ai gjatë hetimit administrativ. Në analizë të vërtetësisë të deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarin gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e kohës e krijimit të pasurive.

46.10 Komisioni në analizë të kohës, vlerës së krijimit/blerjes dhe burimeve të deklaruara për krijimin e këtyre pasurive i është referuar:

Për Qendrën Rezidenciale, Sauk, Tiranë:

- vetëdeklarimit për legalizim nr. ***, të datës 23.03.2005, në të cilën vetëdeklaruesi A. P ka përcaktuar vitin 1996, si vit të ndërtimit të Qendrës Rezidenciale të banimit, në Sauk, me tri vila të njëjta (projektues S. D dhe zbatues shoqëria “****” sh.p.k.); në mungesë të dokumentacionit ligjor për vlerën e krijimit të kësaj pasurie iu referua VKM-së nr. 13, datë 05.01.1998, “Për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, pika 1, ku përcaktohet se kostoja mesatare vjetore në shkallë Republike e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitet 1996 -1997, të jetë 19.581 lekë/m² për sipërfaqe banimi (shfrytëzimi).

Për pasurinë shtëpi banimi 4-katëshe dhe 1 kat nëntokë ndodhur në Rr. “****”.

- Vendimit nr. ***, datë 29.12.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin është pranuar njohja e pronësisë së ndërtimit të kësaj shtëpie banimi (në Rr. “****”).

- Në mungesë të dokumentacionit ligjor për vlerën e krijimit të kësaj pasurie iu referua vendimit nr. ***, datë 09.12.1996, të Këshillit të Ministrave, kostoja mesatare vjetore e ndërtimit të banesave për vitin 1995 nga Enti Kombëtar i Banesave, për qytetin e Tiranës ka qenë 12.883 lekë/sipërfaqe ndërtimi.

47. Analizë e burimeve të deklaruara për krijimin e pasurive

Komisioni kreu një analizë përmbledhëse krahasuese të pasurive të blera dhe të krijuara nga babai i subjektit të rivlerësimit, burimeve kryesore të të ardhurave deri në datë 31.12.1996, mbështetur në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin ligjor shoqërues, të dhënat financiare krahasuese pasqyrohen në tabelën sa më poshtë:

47.1 Analiza financiare, periudha 1994 – 1996

Analizë financiare 1994-1996	Rez. Hetimi	Subjekti	Pas prapësimeve
Përshkrimi	Vlera lekë	vlera Lekë	vlera lekë
Të ardhura nga paga, A. P., periudha 1980 - 1987	0	56515	56515
Të ardhura pension pleqërie, A. P., 1987 - 1992	0	27673	27673
Të ardhura te mbetura nga çmimi i shitjes së vilës (37.238 USD)	3838121	3838121	3838121
Interesa tërhequr nga S .Petku, 1996 (197.200 USD)	20325404	20325404	20325404
Total të ardhura (1)	24163525	24247713	24247713
Blerje pasuri të paluajtshme toka dhe troje viti 1996	11991000	11991000	11991000
Kosto ndërtimi banesa, në Rr. “****”, viti i vetëdeklaruar 1995	17410086	7806502	14815450
Kosto ndërtimi 3 vilat, në Sauk, me sip.1211,7 m ² , viti i vetëdeklaruar legalizim 1996	23726298	10000000	23726298
Kapital themeltar në natyrë për shoqërinë “****” viti 1994 (kamion)	6000000	600000	600000

Pasuri krijuar/blerë (2)	59127384	30397502	51132748
Balance fondesh (1-2)	-34.963.859	-6.149.789	-26.885.035

47.2 Për sa më sipër rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të ardhura të deklaruara, të vërtetuara nga burime të ligjshme për blerjen dhe krijimin e pasurive të paluajtshme të sipërshënuara deri në datë 31.12.1996 (pa llogaritur shpenzimet për jetesë, shkollim etj.).

47.3 Edhe nëse do të merreshin në konsideratë të ardhurat (e të gjithë trungut familjar) e deklaruara nga subjekti në vlerën prej 3.562.380 lekësh, përsëri balanca e fondeve mbetet negative (në kontratën e shitjes me shoqërinë “****”, pronar i kësaj pasurie është përcaktuar vetëm shtetasi A. P).

48.Neni D të Aneksit të Kushtetutës parashikon: “3. *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave*” dhe Ligji nr. 84/2016, në nenin 32, “Deklarimi i pasurisë”, përcakton se: “1. *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*”

49. U arrit të provohet nga hetimi administrativ se deklaratimet e tij janë të pavërteta dhe jo në përputhje me sa parashikohet në Nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 32 të Ligji nr. 84/2016.

Baza ligjore

50. Bazuar në provat dhe faktet e analizuar së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive, në kundërshtim me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e përdorur për krijimin e pasurive.
- (iii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

II. PËR SA I PËRKET SHTËPISË SË BANIMIT, PËRBËRË NGA DY KATE BANIMI DHE BODRUME ME SIPËRFAQE KATI 130 M² (PASURIA NR. 4)

51. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se kjo banesë ka përfunduar procesin e legalizimit, proces i cili ka filluar në vitin 2005, mbi bazën e vetëdeklarimit të bërë nga babai i

subjektit, trashëgimlënësi A. S. P. Kjo banesë ka kaluar në emrin e subjektit gjatë procedurave të legalizimit mbi bazën e dëshmisë së trashëgimisë ligjore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2015, të noteres M. J,

52. Me deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.09.2016, të noteres M. J, trashëgimtarët e tjerë ligjorë të trashëgimlënësit A. S. P kanë hequr dorë nga çdo pretendim pronësie mbi këtë banesë dhe legalizimin e saj vetëm në emrin e subjektit. Kjo banesë aktualisht ndodhet në proces regjistrimi në ZVRPP-në Tiranë. E pavlerësuar deri më sot Pjesa në përqindje: 100 %.

Faktet nga hetimi administrativ

53. ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën kthim përgjigje me nr. ***prot., datë 15.02.2018, konfirmon se z. Fehmi A. Petku, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, zk. ***, lloji i pasurisë ndërtesë me sip. 118 m².

54. Nga kartela e pasurisë rezultoi se kjo pronë është regjistruar në datë 07.03.2017, në emër të Fehmi A. Petku, me përshkrimin e veçantë, leje legalizimi nr. ***, datë 20.10.2016.

55. Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Jug, me shkresën kthim përgjigje me nr. ***prot, datë 13.02.2018, konfirmon se z. A. P figuron vetëdeklarues pranë Njesisë Administrative Nr. ***, me nr. *** prot., viti 2005.

56. Kjo praktikë legalizimi është kaluar në emër të z. Fehmi A. Petku me deklaratën noteriale nr. ***, si dhe është pajisur me lejen e legalizimit nr. ***, datë 20.10.2016, për objektin godinë banimi 2 kate+1 kat nëntokë.

57. Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 19.09.2006, Xh., S. dhe I. P deklarojnë se heqin dorë dhe kërkojnë që procedurat ligjore për legalizimin e objektit “godinë banimi 2 kat+bodrum” e ndodhur në Rr. “****”, ***, Tiranë, të vijojnë në emrin e Fehmi Petkut, pasi nuk kanë dhënë asnjë kontribut financiar në ndërtimin e këtij objekti, duke deklaruar se as sot dhe as në të ardhmen nuk do të kenë asnjë pretendim pronësie mbi të.

58. Për sa i përket kostos së ndërtimit referuar VKM-së nr. 13, datë 05.01.1998, “Për miratimin e kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, pika 1, kostoja e ndërtimit rezulton në vlerën 7.908.766 lekë (pa mobilimin, ambientin e jashtëm e pishinë për Qendrën Rezidenciale).

59. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, nr. ***, datë 17.06.2002, u njoh vërtetimi i faktit juridik të ndërtimit nga kërkuesi A. P të një kompleksi banimi prej tre vilash 3-katëshe, me konstruksione beton arme, të ndërtuara mbi një sipërfaqe trualli pronë e tij prej 5300 m², të ndodhura në lagjen ***, fshati ***, Tiranë.

60. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 iu kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë.

- Duket se ka mungesë të dokumentacionit ligjor financiar lidhur me mundësinë e shtetasit A. P për ndërtimin e objektit me sip. totale 403.9 m², si dhe duket se ka mospërputhje deklarimesh për kohën e ndërtimit të këtij objekti.
- Duket se ka mospërputhje deklarimesh në deklaratën “Vetting” me deklaratën për vitin 2015, pasi në deklaratën “Vetting” është deklaruar vetëm një shtëpi banimi e ndërtuar mbi truallin e mësipërm, e përbërë nga dy kate banimi dhe bodrume me sip kati 130 m², kurse në deklaratën për vitin 2015 janë deklaruar tre shtëpi banimi të ndërtuara mbi truallin e mësipërm.
- Duket se ka mospërputhje të deklaratës “Vetting” me vendimin nr. ***, datë 17.6.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkues A. P, ku vërtetohet fakti juridik i ndërtimit të një kompleksi banimi me tre vila mbi truallin pronë e tij më një sipërfaqe prej 5300 m².
- Duket se ka mospërputhje të deklaratës “Vetting” me vetëdeklarimin për legalizim (përcjellë më shkresën kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 13.02.2018, nga ALUIZNI) të bërë nga babai i subjektit, i ndjeri A. P, më datë 23.03.2005, në pjesën e të dhënave ndërtimore për objektin, tek kushtet e veçanta, përcaktohet “qendër rezidenciale me tre vila të njëjta”.
- Duket se referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 19.09.2016, ku Xh., S dhe I. P, deklarojnë se heqin dorë, dhe kërkojnë që procedurat ligjore për legalizimin e objektit “godinë banimi 2 kat+bodrum”, ndodhur në Rr. “****”, ***, Tiranë”, të vazhdojnë në emrin e z. Fehmi Petkut, pasi nuk kanë dhënë asnjë kontribut financiar për ndërtimin e këtij objekti, konfirmojnë investimin të kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe jo nga babai A. P.

61. Në përgjigje të barrës së provës ai shpjegoi se koha e ndërtimit të tria vilave është shumë e rëndësishme, për këto aspekte:

Së pari: “Duke sqaruar kohën e saktë, lidhur me kryerjen e shpenzimeve për përfundimin e tri banesave të mësipërme, të bëhet e mundur që analiza financiare e bërë nga ekspertët e Komisionit, për periudhën 1994 – 1996 lidhur me vlerën e pasurive, që sipas tyre pretendohet të jenë krijuar deri në datën 31 dhjetor 1996, të rivlerësohet.”

Së dyti: “Duke i konsideruar këto pasuri si të vëna deri në datën 31 dhjetor të vitit 1996, Komisioni në mënyrë të padrejtë, nuk merr parasysh burimet financiare të dokumentuara për periudhën 1 janar 1997-2002, gjatë së cilës familjarët e mi kanë pasur të ardhura të konsiderueshme, që kanë shërbyer si burim për krijimin e të gjitha pasurive të deklaruara në mënyrë të plotë, si në deklaratat periodike, deklaratën “Vetting” dhe para Komisionit, gjatë bashkëpunimit në hetimin administrativ.”

Së treti: “Deklarimet për këto pasuri, ashtu si dhe për çdo pasuri tjetër, janë të bëra në pasqyrim të plotë dhe të saktë të rrethanave faktike, duke deklaruar vlerat reale të tyre, të cilat janë madje më të larta, se ato të vlerat e përlllogaritura nga ana e ekspertëve të Komisionit, vlera të cilat, vërtetohen me burime financiare, që mbulojnë plotësisht këto vlera.

Për sa i përket vlerës së orendive të këtyre banesave pavarësisht se nuk jepet ndonjë vlerë konkrete nga ana e Komisionit, por pretendohet si mundësi shpenzimi, sqarohet Komisionin se nuk është shpenzuar asnjë lek për arredimin e tyre, pasi nga shtatori i vitit 2002 dhe deri më sot arredimi i tyre është bërë nga qiramarrësit, ndërkohë që, në asnjë rast nuk kemi banuar në ato banesa, të cilat edhe sot siç ju kam konfirmuar me dokumente, përdoren me qira nga persona të tretë.”

Arsyetimi ligjor

62. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit bien ndesh me sa ai ka deklaruar se mbas vitit 1996 nuk është krijuar asnjë prone tjetër.

63. Deklarata noteriale, e cila sipas shpjegimeve të subjektit është bërë në bazë të nenit 30/2, të ligjit nr. ***, datë 03.04.2006, “Për legalizimet”, nuk parashikon vetëm marrëveshjen e bashkëpronarëve për ndarjen fizike të pronës në bashkëpronësi.

64. Në deklaratën noteriale, ndryshe nga sa pretendohet nga subjekti i rivlerësimit, palët nuk ndalen vetëm në marrëveshjen për ndarjen fizike të pronës mes bashkëpronarëve, por në këtë deklaratë noteriale palët, Xh., S. dhe I. P, deklarojnë se heqin dorë dhe kërkojnë që procedurat ligjore për legalizimin e objektit: “*godinë banimi 2 kate + bodrum*”, ndodhur në Rr. “****”***, , Tiranë”, të vazhdojnë në emrin e z. F. P, pasi nuk kanë dhënë asnjë kontribut financiar për ndërtimin e këtij objekti.

65. Bazuar në nenet 40 dhe 41, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar, aktet noteriale të hartuara në pajtim me ligjin, kanë fuqinë e akteve autentike.

66. Nga ana tjetër, noterit i ndalohet të redaktojë akte, përmbajtja e të cilëve bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit.

67. Bazuar në sa më sipër, deklarata para noterit konfirmon ligjërisht faktin se investimi është kryer nga subjekti i rivlerësimit.

Baza ligjore

68. Bazuar në provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues, arrin në përfundimin se:

- (i) Trupi gjykues i çmon se mospërputhjet e deklaratës noteriale të depozituara me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, janë fakte që vijnë në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016.
- (ii) Shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (iii) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

III. PËR SA I PËRKET NDËRTIMIT INFORMAL MBI TRUALLIN ME SIPËRFAQE 16000 M² BLERE ME:

- a) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.07.1996, të noteres M. Sh; shitës F. Sh, blerës A. P; sip. 4500 m², çmimi 500 lekë/m². Vlera 4500 m² x 500 lekë/m² = 2.250.000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.
- b) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.07.1996, të noteres M. Sh; shitës O. B, blerës A. P; me sip. 250 m², çmimi 500 lekë/m². Vlera 200 m² x 500 lekë/m² = 125 000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.
- c) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.08.1996, të noteres M. Sh; shitës O. B, blerës A. P; sip. 200 m² x 500 lekë/m²=100 000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.
- ç) Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.07.1996, të noteres M. Sh; shitës F. Sh, blerës A. P sip. 632 m², çmimi 500 lekë/m². Vlera 632 m² x 500 lekë/m² = 316000 lekë. Pjesa takuese: 1/4.

Faktet nga hetimi administrativ

70. ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 15.02.2017, nuk konfirmon të regjistruar në emër të z. Fehmi Petku pasurinë e mësipërme.

71. ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 23.02.2018, informon se në emër të z. A. P figuron si pasuri e tjetërsuar, pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, zk. ***, lloji i pasurisë arë, me sip. 6000 m², ***, Tiranë.

72. Nga kartela e pasurisë rezulton se origjina e kësaj pasurie ka qenë H. M dhe me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.1997, ka kaluar në emër të z. A. P (bashkëlidhur kontrata e shitjes). Ky i fundit e ka tjetërsuar këtë pasuri në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

73. ALUIZNI Tirana Rurale, me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.09.2018, informon Komisionin se nuk administrojnë ndonjë praktikë me deklarues vetë z. Fehmi A. Petku, kurse z. A. S.P rezulton disa herë vetëdeklarues në procesin e vetëdeklarimit, ndër të edhe për një objekt informal të ndodhur në Njësinë Administrative ***.

74. Praktika e legalizimit e subjektit është trajtuar në bazë të dëshmisë së trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2015, për trashëgimlënësin A. S. P.

75. Dokumentacioni është hartuar në emër të trashëgimtarëve Xh. Xh. P, S. A. P, I. A. P, Fehmi A. Petku dhe është emetuar leja e legalizimit nr. ***, datë 16.03.2018.

76. Me deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit, nr. ***, datë 11.12.2014, deklaruesi A. P nis procesin e legalizimit të një ndërtimi pa leje të ngritur në vitin 1996 në ***, Komuna ***.

77. Në lidhje me këtë pasuri iu kërkuan subjektit sqarime, të cilat iu vunë në dispozicion Komisionit në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

78. Në lidhje me ekzistencën e ndonjë ndërtimi mbi këtë truall, subjekti deklaron se mbi truall ndodhet një banesë pjesërisht njëkatëshe dhe pjesërisht dykatëshe, e ndërtuar nga shoqëria tregtare “***” sh.p.k. Ai deklaron se në momentin e nisjes së procedurave të legalizimit subjekti dhe vëllai i tij, I. P, si dhe nëna e subjektit, kanë hequr dorë nga çdo e drejtë mbi këtë objekt dhe mbi përfshirjen në legalizimin e tij.

79. Ky veprim sipas tij vërtetohet me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.06.2016. Sipas tij, pas hartimit të aktit noterial nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë interes pasuror mbi këtë objekt.

80. Për shkak të gjendjes juridike të këtyre pasurive, nuk ishin asnjëra të regjistruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme, nuk është bërë e mundur përcaktimi i pjesëve konkrete takuese me dokumente ligjore.

81. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, iu kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë:

- Duket se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e këtij objekti.

- Duket se ka fshehje të objektit informal të ndodhur në Njësinë Administrative ***, Tiranë, pasi ky ndërtim nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting dhe as në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë për vitin 2017.

82. Në lidhje me këtë rezultat hetimi, subjekti ka deklaruar se ai nuk ka të drejta pasurore mbi këtë pasuri e, për këtë arsye, nuk ka gjetur pasqyrim as në deklaratat periodike e as në deklaratën “Vetting”.

83. Në sqarimet e tij në përgjigjet e pyetësorit të parë, subjekti ka deklaruar se në nisje të procedurave të legalizimit ai dhe vëllai i tij, I. P, si dhe nëna e subjektit, kanë hequr dorë nga çdo e drejtë mbi këtë objekt, si dhe nga përfshirja në legalizimin e tij. Ky veprim sipas tij vërtetohet me deklaratën noteriale nr. *** rep., datë 19.06.2016.

Analiza ligjore

84. Neni 335 i Kodit Civil parashikon: *“Heqja dorë nga trashëgimia mund të bëhet brenda 3 muajve nga çelja e trashëgimisë dhe, kur trashëgimtari është jashtë shtetit, jo më vonë se 6 muaj”.*

85. Nga momenti i çeljes së trashëgimisë ligjore subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar të gjitha pasuritë e trashëguara nga babai dhe për të cilat nuk kishte hequr dorë.

86. Vërehet se deklarata noteriale e heqjes dorë nr. *** rep., datë 19.06.2016, është përpiluar pas një viti nga data e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2015, dhe duhet të ishte deklaruar edhe në deklarinimin për vitin 2015.

87. Referuar shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 13.09.2018, të ALUIZNI-t sipas të cilës rezulton se sipas deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit nr. ***, datë 11.12.2014, deklaruesi A. P, nis procesin e legalizimit të një ndërtimi pa leje të ngritur në vitin 1996, në ***, Komuna ***, që do të thotë se procedurat e legalizimit kanë nisur që në vitin 2014 e ky fakt bie ndesh me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

88. Ndërkohë, deklarata noteriale e heqjes dorë nr. *** rep., datë 19.06.2016, është përpiluar pas një viti nga data e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2015, dhe për këtë arsye duhet të ishte deklaruar në deklarin për vitin 2015.

89. Për sa kohë nuk janë përfunduar procedurat e legalizimit ky objekt duhet të deklarohet nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaratën “Vetting”.

90. Bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Mbi deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”. Në pjesën “Deklarimi i pasurisë nga persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit”, përcakton: “Objekti i deklarin”: *“Të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11, e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur”.*

Baza ligjore

91. Bazuar në provat e faktet e analizuara së bashku, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- (i) Subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, të këtij ndërtimi
- (ii) Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas nenit D, paragrafi 5, të Aneksit të Kushtetutës.
- (iii) Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë.

IV. PRONËSIA MBI AKSIONET E SHOQËRISË “KEPI I DRAGONJVE” SH.P.K.,

Faktet nga hetimi administrativ

92. Shoqëria “***” sh.p.k. është regjistruar me vendim nr. ***, datë 14.06.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën Rr. “***”, nr. ***, Tiranë, dhe me objekt të aktivitetit: “Prodhime inertesh për ndërtim dhe tregtim të tyre tregti me shumicë dhe pakicë import-export artikuj ushqimorë dhe industrialë”, me kapital fillestar 6.000.000 lekë.

93. *Në llogaritë vjetore (gjendjet financiare) të shoqërisë “***” për periudhën 01.01.2001-31.12.2001, janë paraqitur në pasiv të bilancit, në zërin, Detyrime të kërkueshme pas më shumë se një vit (ortakë), gjendje në datë 31.12.2000, në vlerë 47.224.268 lekë dhe në datë 31.12.2001, gjendje në vlerë 58.538105 lekë. Ky fakt është evidentuar edhe në raportin e shoqërisë audituese “***” sh.p.k., në çështjen 4, të raportit (kontrolli i llogarive të detyrimeve) dhe në opinionin përfundimtar të raportit.*

94. Fitimi neto i shoqërisë “***” sh.p.k., deri më 31.12.1999 ka qenë 1.611.475 lekë, ndërsa deri më 31.12.2000 ka qenë 2.552.161 lekë. Ortaku i vetëm, z. A. P, nuk rezulton të ketë të ardhura nga ndonjë biznes tjetër apo të kenë shpërndarë dividend në vlerën prej 47.224.268 lekësh, me qëllim dhënien si borxh shoqërisë “***” sh.p.k. (deri në datën 31.12.2000).

95. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe të provave të dërguara pretendon se atë nuk e lidh asgjë me veprimet e kryera në këtë rast dhe, për rrjedhojë, nuk duhen marrë në analizë nga ana e KPK-së, në këtë proces.

Arsyetimi ligjor

96. Subjekti i rivlerësimit, nuk justifikon pasurine e personit tjetër të lidhur, (babait të tij) ortak i vetëm i shoqërisë “Kepi i dragonjve” sh.p.k., duke mos justifikuar edhe burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së dhënë borxh shoqërisë prej 47.224.268 lekë (deri më 31.12.2000) dhe 58.538.105 lekë (deri më 31.12.2001),

Ky detyrim rrjedh nga parashikimet e pikës 4, të nenit 32, e cila përcakton se: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këtë marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurisë.*”, vërtetuar kjo me:

96.1 Me shkresën nr. *** prot., datë 16.07.2018, rezulton se fitimi neto nga ky aktivitet:

Viti	Fitim neto
1995	29111
1996	517464
1997	301720
1998	122290
1999	640890
2000	940686
2001	882586
2002	-868612
2003	1367903
2004	1946702
2005	2148452
2006	-125473
2007	-1173072
2008	0
2009	0
2010	0
2011	0
2012	0
2013	0
2014	0

Total 6.730.647

96.2 Në shkresën e mësipërme nuk deklarohet shpërndarje dividenti ose jo, si dhe pagesa për tatim mbi të ardhurash personale. Dokumente që vërtetojnë se shoqëria i detyrohet, z. A. P, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë, shumë prej 47.224.268 lekësh (në datën 31.12.2000); *llogaritë vjetore (gjendjet financiare)*, dërguar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 16.07.2018 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë;

- Dokumente që vërtetojnë se fitimi neto i shoqërisë “***” sh.p.k., deri më 31.12.1999, ka qenë 1.611.475 lekë, ndërsa deri më 31.12.2000 ka qenë 2.552.161 lekë.

96.3 Sipas të dhënave të mësipërme, edhe nëse do të ishte shpërndarë dividend, vlera e fitimit neto të vetëdeklaruar deri në datën 31.12.1999 është shumë e ulët në krahasim me borxhin e dhënë shoqërisë.

96.4 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime dhe dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre vlerave monetare.

Baza ligjore

97 .Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku dhe në ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të bindshme burimin e krijimit të ligjshme të këtyre vlerave monetare, sipas paragrafit 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

- Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

V.ANALIZA E TREGUESVE FINANCIARË, PASURI, DETYRIME, TË ARDHURA, SHPENZIME TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT PËR PERIUDHËN 2003 - 2016.

98. Analiza financiare është kryer për të verifikuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime.

98.1 Nga analiza e të dhënave të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, dokumentacioni financiar, pjesë e dosjes përkatëse të ILDKPKI-së, si dhe të dhëna nga institucione shtetërore, subjekte të ndryshme private, si dhe shpjegime të dhëna pas rezultateve të hetimit, për periudhën referuese, Komisioni arrin në përfundimin se për vitet e poshtëshënuara subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe shpenzimet e deklaruar dhe të llogaritura për këto periudha, si më poshtë:

Analiza financiare	Vit 2006	Vit 2007	Vit 2009	Vit 2011
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat subjekti	439432	826784	1190706	1413648
Të ardhura nga shitja e pasurive	0	0	965720	0
Të ardhura të tjera	0	0	0	0

Total të ardhura	439432	826784	2156426	1413648
Pagesë kësti kredie	438429	431101	216200	0
Qira financiare <i>Leasing</i>	0	0	1211065	475063
Shpenzime arredimi shpërndarë	55118	55118	55118	55118
Interesa, kk të tjera	28897	25228	49567	81315
Shpenzime jetese në vit ref. INSTAT, ILDKPKI	657342	1415808	819720	819720
Total shpenzime	1179786	1927255	2351670	1431216
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe deklarimi	0	0	0	0
Ndryshim mj. monetare banke gj. fillim - gj. fund periudhe	80549	-6536	-655169	6734
Mjete monetare të disponueshme (1)	-659805	-1107007	-850413	-10834
Pagesa për krijim pasurie	0	0	0	0
Detyrime	0	0	0	0
Pasuri neto (2)	0	0	0	0
Balanca e fondeve (1-2)	-659805	-1107007	-850413	-10834

Analiza financiare	Viti 2012	Vit 2013	Vit 2014	Vit 2015
Përshkrimi	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë	Vlera në lekë
Të ardhurat neto nga pagat e subjektit	1579094	1530192	1578303	1684776
Të ardhura nga shitja pasuri	0	0	0	1235520
Të ardhura të tjera, qira	0	0	0	1867552
Të ardhura: djali Alban	0	0	0	3570
Kredi, hua të tjera	0	1000000	0	0
Total të ardhura	1579094	2530192	1578303	4791418
Pagesë këst kredie	0	0	414575	408260
Qira financiare <i>Leasing</i>	480121	1537043	764267	1005137
Shpenzime arredimi shpërndarë	55118	55118	55118	55118
Interesa, kk të tjera	95774	126268	143851	141575
Shpenzime shkollimi	70000	275951	438463	451560
Shpenzime jetese në vit ref. INSTAT, ILDKPKI	837288	846144	1319988	1345656
Total shpenzime	1538301	2840524	3136262	3407306
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> gj. fillim - gj. fund periudhe deklarimi	0	0	0	-1029600

Ndryshim mj. monetare banke gj. fillim - gj. fund periudhe	-53690	146359	5611	250414
Mjete monetare të disponueshme (1)	-12897	-163973	-1552348	604926
Pagesa për krijim pasurie	0	0	0	1565306
Detyrime	0	0	0	0
Pasuri neto (2)	0	0	0	1565306
Balanca e fondeve (1-2)	-12897	-163973	-1552348	-960380

Baza ligjore

99. Bazuar në të gjitha provat e faktet e analizuara së bashku dhe në ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

-Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të bindshme burimin e ligjshëm të të ardhurave për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe shpenzimet e deklaruara dhe të llogaritura sa më sipër, sipas nenit D, të paragrafit 3, të Aneksit të Kushtetutës.

-Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për vlerësimin e pasurisë sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

100. Konkluzioni për vlerësimin pasurisë

Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues, në unanimitet, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë rezultateve të hetimit. Në zbatim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ndaj tij zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit

B. VLERËSIMI I FIGURËS

101. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës, dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport fillestar me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

102. Në përfundim të këtij raporti konstatohet përshtatshmëria e subjektit, por theksohet fakti se ky raport është hartuar në mungesë të informacionit nga njëri prej organeve ligjzbatuese. Pas ardhjes së informacionit të munguar, me kërkesë të Komisionit nr. *** prot., datë 01.02.2018, DSIK-ja ka rishikuar raportin për subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku.

103. DSIK-ja ka dërguar raportin me shkresën nr. *** prot., datë 15.02.2018, e deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. *** prot., datë 16.02.2018. Pas procedurave të kryera nga

Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi A. Petku, me detyrë gjyqtar (kryetar) në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, DSIK-ja konkludon në *papërshtatmëri të subjektit për vijimin e ushtrimit të detyrës.*

B/1 RIVLERËSIMI I FIGURËS NGA KOMISIONI

104. Informacioni që përmbante Raporti i Grupit të Punës së DSIK-së iu nënshtrua një hetimi administrativ, për të krijuar bindjen në vërtetësinë e informacionit të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese. Ky hetim konsistoi në verifikimin e rrethanave, përfshirë edhe të atyre lehtësuese, që kishin çuar Grupin e Punës në konstatimin e papërshtatshmërisë së subjektit për vazhdimin e detyrës, si dhe vërtetësisë së ngjarjeve konkrete, me qëllim gjetjen e provave, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

105. Bazuar në raportin e DSIK-së, rezultojnë se disponohen të dhëna për subjektin e rivlerësimit se ngrihen dyshime për përfshirje në korrupsion pasiv gjatë gjykimit të disa çështjeve gjyqësore. Autoritetet verifikuese bëjnë gjithashtu me dije se disponohen të dhëna për djalin e subjektit të rivlerësimit, shtetasin Bekim Petku.

106. Pasi u njoh me këtë Raport, Komisioni u përqendrua në verifikimin e fakteve, si dhe në krijimin e bindjes së brendshme. Duke qenë se informacioni është i klasifikuar, si dhe rrezikon sigurinë e burimit, ai nuk mund të bëhet publik.

106.1 Por, Komisioni u njoh me fakte, ngjarje, rrethana, të cilat u konsideruan të mjaftueshme për t'i kaluar subjektit barrën e provës. Pasi iu vu në dispozicion Raporti i deklasifikuar pjesërisht, bazuar në nenin 52, të ligjit 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime të mëtejshme.

106.2 Subjekti ka sqaruar se: *“...Raportin e dytë të paraqitur nga DSIK-ja e gjej të padrejtë, të pabazuar në prova, si dhe në kundërshtim flagrant me kërkesat e nenit 34 e vijues të ligjit nr. 84/2016 të sipërcituara.”*, por nuk ka dhënë asnjë provë apo sqarim bindës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

106.3 Të njëjtin qëndrim subjekti mbajti edhe në seancën dëgjimore.

106.4 Pasi dëgjoi subjektin në seancë, shqyrtoi edhe shpjegimet e tij me shkrim, si dhe provat e paraqitura në raport me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioni, vlerëson se raporti i DSIK-së përmban elementet e parashikuara në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016, dhe ai konsiderohet i plotë, dhe se subjekti nuk arriti të bindë për të kundërtën e rezultatit të këtij raporti.

107. Konkluzioni për vlerësimin e figurës

Në përfundim, shumica e trupit gjykues konkludon për subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku, se është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar, për shkak të mundësisë për vënien e tij nën presion nga strukturat kriminale, për favorizim apo për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, në papajtueshmëri të plotë me detyrën.

C.VLERËSIMI PROFESIONAL

108. Raporti i vlerësimit profesional është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË

109. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Fehmi Petku ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës, në datën 30.03.1994. Pas studimeve, më 25.04.1994, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më 12.06.2009 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Në vijim, më 19.06.2015 emërohet Kryetar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

110. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtarin Fehmi Petku janë paraqitur gjithsej 4 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (asnjë ankesë në vitin 2013, asnjë ankesë në vitin 2014, 3 ankesa në vitin 2015 dhe 1 ankesë në vitin 2016).

111. Tri ankesa të vitit 2015 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, dy ankesa me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe ankesa e tretë ka rezultuar e përsëritur. Një ankesë e vitit 2016 është verifikuar në lidhje me procedurën e hedhjes së shortit, por është arkivuar pasi pretendimet rezultuan të pabazuara.

112. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Fehmi Petku përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E GJETJEVE

113. Aftësitë profesionale. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, rezultoi se katër çështje janë përfunduar brenda afateve standard, ndërsa vetëm njëra prej tyre është përfunduar tej këtij afati. Në të vetmin rast ku është tejkalar afati i gjykimit ka rezultuar se pesë seanca gjyqësore të caktuara nuk kanë qenë produktive, pasi janë shtyrë për mosformim të trupit gjykues, për shkak të numrit të lartë të dorëheqjeve dhe të nevojës për delegim gjyqtarësh nga KLD-ja.

114. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtari Fehmi Petku nuk i kushton sa duhet rëndësi arsyetimit në kohë të vendimeve, pasi në asnjë rast vendimi nuk është arsyetuar brenda afatit ligjor 5-ditor, por duhet konsideruar e evidentuar se gjyqtari Fehmi Petku ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Ai ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, por ka arsyetuar me vonesë vendimet gjyqësore.

115. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara rezultoi se i vetmi rast i konstatuar, që subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, nuk ka respektuar rregullat procedurale, është ai i shtyrjes së seancës gjyqësore të datës 10.06.2014 për shpalljen e vendimit përfundimtar në ngarkim të të pandehurit Ll. D etj., në datën 17.06.2014, qëndrim i cili bie ndesh me njëhershmerinë e marrjes së vendimit, të parashikuar nga neni 379 i Kodit të Procedurës Penale.

116. Së fundmi, në këtë aspekt duhet evidentuar se nga kontrolli gjyqësor i Gjykatës së Lartë mbi pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar gabime gjyqësore. Në tre raste Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, ndërsa në dy rastet e tjera Gjykata e Lartë nuk është shprehur ende.

117. Nga hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me vlerësimin profesional rezultoi se:

117.1 KLD-ja⁷ informoi Komisionin se për subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku, në periudhën janar 2006 deri më sot disponohen gjashtë ankesa, të cilat i përkasin shtetasit S. H, përkatësisht të vitit 2008 dhe 2009, shtetasit I.S në vitin 2015, shtetasit Q.A në vitin 2015, shtetasit O. Sh në vitin 2016, si dhe subjektit “Jurisprudenca” e vitit 2017. Për këto ankesa nga ana e KLD-së është vendosur arkivimi i tyre.

118. Në lidhje me vlerësimet për masa disiplinore për këtë subjekt, rezulton se, në datën 21.03.2006, është paraqitur kërkesa e Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj gjyqtarit Fehmi Petku, për të cilën KLD-ja, me vendimin nr. ***, datë 24.11.2006, ka vendosur pushimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit si rezultat i tërheqjes së kërkesës për procedim nga Ministri i Drejtësisë.

119. Ministria e Drejtësisë⁸ ka përcjellë ndër të tjera kërkesën nr. *** prot., datë 21.03.2006, e Ministrisë së Drejtësisë me lëndë: *“Procedim disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vendim i Ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor të këtij gjyqtari dhe propozimin për transferimin e tij në një gjykatë tjetër nga ana e KLD-së”*.

120. Sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë rezulton se gjyqtari Fehmi Petku në gjykimin e disa çështjeve penale ka lejuar shkelje të ligjit material e procedural.

121. Shkeljet e kryera nga z. Fehmi Petku, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, gjatë gjykimit të çështjeve penale, në moszbatim të kërkesave të nenit 59 të Kodit Penal, nenit 141 të Kodit të Procedurës Penale, konsistojnë në kryerjen e veprimeve që vlerësohen në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, duke favorizuar padrejtësisht të pandehurit, dhe ka cenuar besueshmërinë e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor, prandaj në kuptim të neneve 40, 41 dhe 42 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përbëjnë shkelje disiplinore.

122. Në sqarimet e tij subjekti ka deklaruar se procedimi disiplinor i iniciuar ndaj tij ka qenë i padrejtë dhe, për këtë arsye, KLD-ja me vendimin nr. ***, datë 24.11.2006, ka vendosur pushimin e procedimit disiplinor, si rezultat e tërheqjes së kërkesës për procedim nga Ministri i Drejtësisë. Sipas tij tërheqja e Ministrit të Drejtësisë nga kërkesa për procedim presupozon që nuk ka pasur fare procedim disiplinor dhe, për rrjedhojë, kjo e dhënë nuk duhet të merret fare në konsideratë.

⁷ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 13.03.2018, nga KLD-ja në dosjen e Komisionit.

⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 27.3.2018, nga MD-së në dosjen e Komisionit.

123. Sipas tij, çështjet e referuara i përkasin periudhës 2003 – 2004 dhe, për rrjedhojë, edhe në aspektin procedural, bazuar në nenet 40 dhe 41, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 117, të ligjit nr. 96/2016, nuk mund të jenë objekt vlerësimi nga ana e Komisionit.

124. Iu kërkua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹ informacion për çdo çështje civile apo penale në të cilën shtetasi V. A ka qenë palë në gjykim dhe vendimet gjyqësore përkatëse, si dhe dosja e plotë që i përket çështjes penale nr. *** në ngarkim të shtetasit V. A.

125. Gjatë hetimit administrativ konstatohet se me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.04.1996, shtetasi A. P i shet shtetasit V. A shtëpinë e ndodhur, në Rr. “***”, nr. ***, Tiranë, me përbërje bodrume dhe tri kate ndërtuar me mur tulle dhe papafingo, në vlerën 520.000 USD.

126. Pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se nga shitja e banesës së ndodhur në Rr. “***”, nr. ***, janë krijuar dhe të gjitha pronat e tjera në vitin 1996 dhe se nga ai vit nuk është shtuar asnjë pasuri tjetër.

127. Referuar vendimit të Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 5.10.1999, rezultoi se, z. Fehmi Petku, ka gjykuar çështjen penale nr. ***, në ngarkim të shtetasit V. A, ku ky i fundit i akuzuar për veprën penale “*të vjedhjes me anë të mashtrimit në bashkëpunim, kryerje të krimeve nga organizata kriminale*”, ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. ***, datë 30.07.1999, e cila kishte vendosur përjashtimin e gjyqtarit F. P nga gjykimi i çështjes, duke kërkuar mospërjashtimin e tij. Pra, subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në gjykimin me palë shtetasin V. A, kur ky i fundit ka pasur marrëdhënie interesi (kontratë shitjeje datë 19.04.1996; kontratë huaje datë 27.04.1996, aktmarrëveshje datë 28.04.1996) me babanë e tij, z. A. P.

128. Në lidhje me këtë subjektit iu kalua barra e provës. Në shpjegimet e tij me shkrim ai sqaron: “*Është e vërtetë që nga aktet e procedimit, unë mbi bazën e procedurave të ndarjes së çështjeve nga Kryetari i Gjykatës jam caktuar në përbërje të trupit gjykues të çështjes në ngarkim të shtetasit V. A. Nga aktet e atij gjykimi, rezulton se unë nuk kam marrë pjesë në gjykimin e çështjes, as në shqyrtimin gjyqësor dhe as në vendimmarrjen përfundimtare në atë gjykim, siç pretendohet në raportin paraprak.*”

128.1 Edhe në seancë subjekti deklaroi: “*Lidhur me konfliktin e interesit për rastin kur unë jam përfshirë në një gjykim të shtetasit V. A, në një proces penal të ngritur ndaj tij, për akuza që u ngritën për aktivitetin rentier të tij, është e vërtetë që unë kam hyrë në trup gjykues, por nuk kam hyrë me qejfin tim. Procedurat për caktimin e çështjeve janë përgjegjësi e drejtuesit të gjykatës, ashtu siç e bëj unë sot me kolegët e mi dhe nëse pasi caktohesh, ka dy rrugë për të ikur nga çështja: ose me dorëheqje ose me përjashtim. Dorëheqja në rastin konkret në nenin 17 ka të përcaktuar qartë: “Nëse gjyqtari, bashkëshorti apo fëmija i tij është në një marrëdhënie huaje me personin, pra, është një rast taksativ.” Unë nuk isha në këtë, nuk kisha as marrëdhënie huaje, as kurrëgjë, isha i ndarë si familje, bëja punën time si gjyqtar, ndërkohë që marrëdhënia ime, marrëdhënia e familjarëve të mi me Vehbiun nuk ekzistonte më. Nuk ekzistonte, sepse me ligjet e shtetit që kanë trajtuar firmat piramidale të gjitha të drejtat e subjekteve, drejtues të*

⁹ Shkresa nr. *** prot, datë 8.2.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

këtyre firmave, kishin kaluar në emër të likuidatorëve; ishte shteti përfaqësues, pra, nuk kishte më marrëdhënie midis nesh dhe V. A në ato procese gjyqësore apo për shkak të kontratave të huas të lidhura me të. Marrëdhënia tani ekzistonte midis familjarëve të mi dhe administratorëve të shoqërisë, shtetit. Atëherë çfarë konflikti kam unë me V.? Edhe sikur të kisha vazhduar gjyqin deri në fund, edhe do ta bëja atë gjyq pa asnjë pishman, dhe do ta dënoja për të gjitha ato zallamahi që i shkaktoi këtij vendi... Pra, e konsideroj veten jo në konflikt interesi, megjithatë edhe sikur të kisha qenë, në konflikt interesi mund të quhesha nëse do të kisha dhënë vendimin përfundimtar, por thjesht pjesëmarrja ime në dy seanca nuk mund të konsiderohet në konflikt interesi dhe mos harroni se bëhet fjalë për vitin 1999.”

129. Nga dosja e administruar konstatohet se:

- çështja me të pandehur V. A dhe të tjerë, të akuzuar për vjedhje me anë të mashtrimit në bashkëpunim dhe kryerje të krimeve nga organizata kriminale, është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 27.04.1999;
- gjyqtari i çështjes është caktuar Fehmi Petku;
- me vendimin e datës 17.05.1999, gjyqtari Fehmi Petku, ka caktuar seancën gjyqësore në datë 28.05.1999;
- në datën 21.05.1999, subjekti i ka kërkuar togës së shoqërimit, shoqërimit e këtij të pandehuri në seancën e datës 26.05.1999;
- janë zhvilluar dy seanca gjyqësore datë 28.05.1999 dhe 16.06.1999;
- në seancën gjyqësore të datës 16.06.1999, prokurori i çështjes A. Gj, ka kërkuar përjashtimin e kryesuesit Fehmi Petku, pasi vazhdimi i gjykimit nga ana e tij përbën shkelje të nenit 17, pika 1, germa a), pasi ka interes në këtë procedim penal, për arsye se vëllai i tij është dëshmitar në këtë çështje duke qenë se ka depozituar para në firmën “***”. Në fund të seancës, trupi gjykues, vendosi ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për t’ia dërguar aktet Gjykatës së Apelit të shqyrtojë kërkesën e prokurorit për përjashtimin e kryesuesit të trupit gjykues;
- po sipas dosjes gjyqësore, rezulton se z. S. P, vëllai i subjektit, është paraqitur me cilësinë e dëshmitarit në këtë proces;
- në kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, paraqitur para Gjykatës së Apelit Tiranë, të datës 16.06.1999, referohet se gjyqtari Fehmi Petku ka interesa të lidhur me të pandehurin V. A, pasi ai së bashku me prindërit dhe vëllezërit në prill të vitit 1996 i shesin një shtëpi trekatëshe si karabina e papërfunduar në shumën prej 520.000 USD (shtëpi e cila sot është në emër të kompanisë “***“, dhe në fakt aty banojnë po këta njerëz);
- në datë 17.06.1999, gjyqtari Fehmi Petku ka paraqitur mendimin e tij me shkrim në lidhje me kërkesën për përjashtim, në të cilën ai shprehet se kërkesa e prokurorit të çështjes është e padrejtë dhe e pabazuar në ligj pasi çështja në fjalë nuk ka qenë një marrëdhënie direkt e tij ose e bashkëshortes dhe e fëmijëve të tij;

- Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 30.07.1999, vendosi përjashtimin e gjyqtarit Fehmi Petku nga gjykimi i çështjes penale nr. *** në ngarkim të të pandehurit V. A etj;
- ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë i pandehuri V. A;
- Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 24.08.1999, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur dhe lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 30.07.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

130. Në analizë të fakteve dhe të qëndrimit të mbajtur në seancë në deklarimin e tij me shkrim shumica vlerëson se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, ai ka pranuar, madje ka drejtuar dy seanca gjyqësore kundër V. A, në një kohë kur vetëm tre vjet para këtij gjykimi familjarët e tij, të cilët jetonin në të njëjtën shtëpi me subjektin, kishin hyrë në marrëdhënie tregtare me këtë të pandehur.

131. Këtij fakti duhet t'i shtohet gjithashtu edhe deklarimi i subjektit, sipas të cilit, nga të ardhurat nga shitja e kësaj banese në Rr. "****", nr. ***, Tiranë, janë krijuar dhe të gjitha pronat e tjera në vitin 1996, një pjesë e të cilave kanë kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit, z. Fehmi Petku, nëpërmjet trashëgimisë.

132. Në mendimin e paraqitur prej subjektit në datën 17.06.1999, pjesë e dosjes gjyqësore të administruar nga Komisioni, pas kërkesës së prokurorit për përjashtimin e tij, ai ka argumentuar se nuk ndodhet në kushtet e nenit 17, të Kodit të Procedurës Penale, duke anashkaluar këtu pikën "ë" të këtij neni, sipas të cilit legjitimohet dorëheqja e gjyqtarit "*kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie*".

133. Duke pasur parasysh këto fakte, shumica konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, duke ushtruar funksionin e tij në kushtet e një konflikti të hapur interesi, që rezulton i njohur edhe nga prokurori i asaj çështjeje, ka cenuar rëndë etikën e gjyqtarit.

KONKLuzion Përfundimtar

Megjithëse shkelja e etikës së gjyqtarit, për shkak të ushtrimit të detyrës në kushtet e konfliktit të interesit është jashtë periudhës së rivlerësimit, shumica çmon se ky veprim ka lidhje me vlerësimin e kriterit pasuror të subjektit, përveçse vlerësimit të aftësive profesionale të tij.

Në përfundim të vlerësimit tërësor të të tria kriterëve: të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit profesional, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit 84/2016, duke përfshirë këtu edhe etikën e gjyqtarit, shumica konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar rëndë besimin e publikut të drejtësia.

DENONCIME NGA PUBLIKU

132. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku, janë administruar ankesat:

132.1 Denoncimi nr. *** prot., datë 08.02.2018, nga shtetasi V. Ç.

Në ankesën e tij shtetasi V. Ç denoncon për korrupsion dhe për figurën një grup prej 11 subjektsh rivlerësimit, ndër të cilët edhe subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku.

Ai pretendon se është dëmtuar nga këta subjekte, por nuk referon shkeljet konkrete të kryera nga subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, dhe shpreh pakënaqësi për rrëzimin e kërkesës së datës 24.05.2017 nga ky gjyqtar.

Nga analiza e denoncimit të paraqitur në raport me elementet e nenit 53, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoj se në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku, nuk referoj asnjë shkelje ligjore (e procedurale) apo veprime korruptive të kryera prej tij.

132.2 Denoncimi nr. *** prot., datë 04.01.2018, nga shtetasi E. A.

Në ankesën e tij, denoncuesi E. A (përfaqësues i fshatit ***), denoncon subjektin e rivlerësimit, z. Fehmi Petku, lidhur me aftësitë e tij profesionale. Ai pretendon se gjyqtari Fehmi Petku ka dhënë një vendim absurd (vendim nr. ***, datë 24.04.2003), nëpërmjet të cilit pa pasur asnjë dokument origjine i ka kthyer familjes L. nga fshati fqinjë Selbë, sip. prej 100.000 m² (pyll - mal), që është territori i fshatit ***, me kufi verior ***, ku *** kufizon me fshatin *** dhe jo me ***.

Hetimi i kryer nga Komisioni

132.3 Më datën 05.11.2018¹⁰ u zhvillua seanca dëgjimore për marrjen e dëshmisë së z. E. A dhe z. A. A nga fshati ***, Tiranë, në lidhje me denoncimin e depozituar pranë Komisionit.

132.4 I është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹¹ dosja e plotë e vendimit nr. ***, datë 24.04.2003, nr. *** akti, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të gjyqtarit Fehmi Petku.

132.5 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹² vuri në dispozicion të Komisionit dosjen gjyqësore, nr. *** akti, nr. *** vendimi, datë 24.04.2003. Nga aktet në përmbajtje të dosjes rezultoi se:

132.6 Me kërkesëpadinë e datës 07.01.2003, paditësi R. Li është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesëpadi me objekt: “Vërtetimin gjyqësisht të një sipërfaqeje toke (zabel) me sip. 42.5 dynym të ndodhur në fshatin ***të Qarkut Tiranë”. Në kërkesëpadi ai referon se është një prej trashëgimtarëve të të ndjerit Z. L (babai), i cili, siç rezulton nga vërtetimi i pronësisë me nr. ***, datë 23.10.2001, lëshuar nga Këshilli i Qarkut Tiranë ka pasur në pronësi një sipërfaqe toke prej 33.1/4 dynym e ndodhur në fshatin *** të Qarkut Tiranë. Kjo sipërfaqe në terren është më e madhe se ajo që ai ka të regjistruar në dokumentacionin e vjetër kadastral para vitit 1946.

132.7 Deklaratë noteriale e datës 21.10.2002, sipas të cilës deklaruesit D. M dhe A. L deklarojnë se janë kufitarë përkatësisht nga ana veriore dhe jugore me ish-pronarin Z. L.

¹⁰ Shihni procesverbalin e datës 05.11.2018 për marrje dëshmie të shtetasve E. A dhe A. A, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.11.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethi Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.11.2018. nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

132.8 Nga analiza e vendimit të mësipërm duket se në rastin konkret gjyqtari i vetëm Fehmi Petku, nëpërmjet tejkalimit të objektit të padisë, ka dhënë një vendim në kundërshtim me nenin 6, të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”, si dhe nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm”.

133. Në lidhje me këtë subjekti deklaroi se në aspektin formal dhe procedural ligjor, Komisioni ka kryer verifikimet në kundërshtim me nenin 117, të ligjit nr. 86/2016, “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në rastin konkret kanë kaluar 16 vjet nga dhënia e vendimit objekt verifikimi dhe, për rrjedhojë, në çdo rast duhet vendosur arkivimi i ankimit të paraqitur nga ankuesi E. A, me nr. *** prot., datë 04.01.2018.

134. Në referim të Gjykatës Kushtetuese, e cila shprehet në vendimin 2 /2017: “Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”, Komisioni vendosi që kjo çështje nuk mund të ndikojë në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit duke qenë e vetmja çështje ku u konstatuan gabime nga subjekti i rivlerësimit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Në analizë të deklaratimit të subjektit të rivlerësimit: (i) deklaratës së pasurisë “Vetting”; (ii) raportit të hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) raporteve të DISK-së; (iv) provave shkresore nga DSIK-ja; (v) formularit për kontrollin e figurës dorëzuar nga subjekti pranë DSIK-së; si dhe (vi) Raporti vlerësimit profesional përparitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (vii) provave shkresore të administruara nga Komisioni (viii) shpjegimeve dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ si dhe në seancë dëgjimore, trupi gjykues, në unanimitet, arrin në përfundimin se:

- (i) Bazuar në paragrafin 3, të nenin 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të evidentuar në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij, sipas pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Ndërsa shumica arrin në përfundimin se:

- (iii) Subjekti i rivlerësimit është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar, për shkak të mundësisë për vënien e tij nën presion nga strukturat kriminale, për favorizim apo për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, në papajtueshmëri të plotë me detyrën.

- (iv) Në vlerësim tërësor të të tria kritereve: të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit profesional, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar rëndë besimin e publikut të drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fehmi Petku, gjyqtar e drejtues në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 09.04.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (Bungo)
Kryesuese

Pamela Qirko
Anëtare

Xhensila Pine
Relatore

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

MENDIM PARALEL

Si relatore e çështjes për subjektin e rivlerësimit z.Fehmi Petku, kam ndarë mendim të ndryshëm me shumicën e trupës gjyquese, në lidhje me përfundimin e arritur në rivlerësimin e kontrollit të figurës dhe zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat në vlerësimin tim nuk janë shkaqe që përlligjin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Arsyetimi i këtij mendimi paralel nuk afekton qëndrimin tim pro shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z.Fehmi Petku, për shkarkimin bazuar në paragrafin 3 të nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me përfundimin e arritur në rivlerësimin e pasurisë.

1. Në lidhje me rivlerësimin e figurës

Ligji nr. 84/2016, parashikon se kontrolli i figurës bëhet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, dhe në ligjin nr. 84/2016, bazuar në dy elemente që plotësojnë njëra tjetrën

- a) konstatimin e ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, çka përbën elementin përmbajtësor të këtij kontrolli dhe
- b) konstatimin e plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramit, çka përbën elementin formal të këtij kontrolli.

1/A Për sa i përket elementit përmbajtësor të kontrollit të figurës

1.1 Rrethanat që merren parasysh në konstatimin, se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, përcaktohen në pikën 4 të nenit 38, të cilat janë kur:

- a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- b) subjekti i rivlerësimit, ose personi i lidhur me të, ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- c) subjekti i rivlerësimit, ose një person i lidhur me të, ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë, ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar.

1.2 Pika 3, e nenit 15, e ligjit nr. 84/2016, parashikon se, që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar”, duhet të jetë dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.

1.3 Në aktet e administruara nuk rezultuan të dhëna se subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte me persona të dënuar ose të proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të

Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 84/2016.

1.4 Në aktet e administruara nuk rezultuan të dhëna se djali i subjektit të rivlerësimit, B.P., është i dënuar ose i proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 84/2016.

1/B Për sa i përket elementit formal të kontrollit të figurës

1.5 Standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni DH i Aneksit të Kushtetutës dhe nga ligji nr. 84/2016. Formulari i deklarimit të subjektit të rivlerësimit, pas hetimit të kryer nga Komisioni, rezultoi se ishte i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

Per sa më sipër analizuar në pikat I/A dhe I/B të këtij mendimi paralel kam vlerësuar se konkluzioni: *“Subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar, për shkak të mundësisë për vënien e tij nën presion nga strukturat kriminale, për favorizim apo për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, në papajtueshmëri të plotë me detyrën”*, nuk gjen kualifikim në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Në lidhje me zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 si shkak për shkarkim

Kam ndarë qëndrim të ndryshëm me shumicën e trupës gjyquese edhe lidhur me zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Cenimi i besimit të publikut duhet të jetë detyrimisht i lidhur me veprime apo sjellje të subjektit të rivlerësimit që konsiderohen se përbëjnë shkelje të normave ligjore në fuqi.

Vetëm pasi konstatohet një rrethanë e tillë mund të vijohet me analizën nëse kjo sjellje ka cenuar ose jo besimin e publikut në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *“Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.*

Nga vlerësimi tërësor, kam vlerësuar se veprimet apo sjelljet e subjektit të rivlerësimit, nuk paraqesin shkelje të tilla të normave ligjore në fuqi, të cilat të përlligjin perfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Fehmi Petku, ka cenuar besimin e publikut në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

XHENSILA PINE

RELATORE

